



V. K. M. nr. 384

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR
ZYRA E STREHIMIT

Nr. 5204 - Prot

Maliq, më 19.10.2022

LËNDA: Shpallje publike.

NJËSISË ADMINISTRATIVE _____

THIRRJE PËR APLIKIM MBI SUBVENCIONIN E QIRASË.

Në mbështetje të ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social", VKM nr.384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore" njoftojmë të gjithë të pa strehët e bashkisë Maliq se aplikimet e reja për programin e subvencionit të qirasë, për vitin buxhetor 2023 do të jenë të hapura deri më datë 30.11.2022.

Familjet të cilat kanë përfituar subvencion qiraje gjatë vitit 2022 dhe janë të interesuara për risubvencionim për vitin 2023, duhet të paraqiten për të rifreskuar dokumentacionin përpara datës 30.11.2022, në rast të kundërt trajtimi me këtë program strehimi do të ndërpritet në fund të këtij viti buxhetor.

Për çdo informacion mbi mënyrën e aplikimit dhe dokumentacionin e kërkuar, lutemi të paraqiteni pranë zyrës së strehimit bashkia Maliq ose klikoni në Website-n <https://www.bashkiamaliq.gov.al>, në hapësirën "Njoftim për Strehim Social".

Faleminderit për mirëkuptimin.

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

